

AKT THEMELIMI

i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “Balkan Beauty & Cosmetics“ shpk

Tiranë, sot më datë 04 Tetor 2024, në cilësinë e “ortakeve themelues”:

Z.Olti Yzellari, atësia Fatos, i datëlindjes 13.05.1989, Pogradec, Shqipëri dhe banues në: “Rruga 10 Dëshmorët e Pojskës, Lagjia nr 1, Pogradec 7301, Shqipëri”. Shtetas Shqiptar, madhor, me zotësi juridike për të vepruar, mbajtës i kartës me nr. ID I90513108G.

Të cilët në cilësinë e “ortakeve themelues”, me vullnet të lirë, të plotë e të sinqertë, hartuan këtë akt themelimi për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin “BALKAN BEAUTY & COSMETICS” shpk, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901 datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, të ndryshuar me ligjin 129/2014, në ligjin 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, në Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor.

KREU I

Neni 1

Krijimi

Shoqëria “BALKAN BEAUTY & COSMETICS” shpk është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur “Shoqëria”). **Emri tregtar i shoqërisë “Balkan Beauty & Cosmetics”.**

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria “BALKAN BEAUTY & COSMETICS” shpk, është një shoqëri tregtare, e themeluar nga “ortaket e shoqërisë”, të cilët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributet e ortakeve përbëjnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortaku gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që kanë dhënë në kapital.

Neni 3


Selia

Shoqëria e ka selinë kryesore në Rruga 1 Qershori zona kadastrale nr.8581, Pogradec, Shqipëri. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, dege, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Ortakut të Shoqërisë.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë

Tregtim me shumicë dhe me pakic i produkteve të ndryshme të kujdesit personal dhe artikujve të tjerë të përdorimit dermo estetik. Tregtia e pajisjeve dhe aksesoreve të ndryshëm të përdorshëm për kurimin esteik personal etj.



Neni 5
Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.

KREU II
KAPITALI

Neni 6
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë.

Kapitali i mësipërm është nënshkruar dhe do të shlyhet sapo të hapen llogaritë bankare të shoqërisë tërësisht në të holla nga “ortaket e shoqërisë”.

Z. Olti Yzellari është zotërues i një kuote me vlerë 100.000 lekë, e cila përfaqëson 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta) Ortaku përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 7
Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë dhe në shërbime, nëpërmjet emërimit të një eksperti të autorizuar për këto kontribute në natyrë.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim nga Administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Neni 8
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit



tij në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU II

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9

Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakut është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakut është organi vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasyqruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Asambleja e Ortakut, vendos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e Administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve;
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga Administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj Administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 10

Administrimi

Administratorët e shoqërisë janë:

Zi.Viola Pulia i identifikuar me nr ID: I45108062I

Administratori i shoqërisë do të ushtrojë kompetencat e administrimit për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblesë së Ortakut të shoqërisë.


Administrator i shoqërisë mund të emërohet edhe një person i tretë jashtë ortakërisë.

Neni 11

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Ortakut;




- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - ç) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara Asamblesë së Ortakut për miratim;
 - d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- Administratori është i detyruar të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Ortakut edhe në rastet kur : sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të tij, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5% (pesë për qind) të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara. Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjithë personave fizikë e juridikë, publike dhe/ose private, vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, Bankave të të gjitha niveleve, zyra të tatim taksave, autoriteteve doganore, përfshi këtu edhe autoritetet gjyqësore të të gjitha shkallëve. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e tij.
- Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i Administratorëve e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke pasur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 12

Përgjegjësitë

- Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
- Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e Ortakut që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen Administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për tu përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht, sipas rastit pasojat përkatëse.
- Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Administratori detyrohet:
1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
 - d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave së tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
 3. Nëse Administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t’i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet që rrjedhin nga kryerja e shkeljes,



si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një Administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë por pa u kufizuar në to, Administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohet që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Neni 13

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përgjithësisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Neni 14

Bilanci i shoqërisë dhe dividendet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblesë së Ortakut, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Asamblesë së Ortakut vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislativës shqiptare. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 16

Dispozita përfundimtare

Ky Akt themelimi i shoqërisë "BALKAN BEAUTY & COSMETICS" shpk, u redaktua me vullnet të lirë e të plotë të "ortakeve themelues", në dy ekzemplare me vlera të njëjta juridike në gjuhën shqipe.

ORTAKËT E SHOQËRISË

Z. Olti Yzellari

Olti Yzellari

